

Komuna e Kërçovës

Р. Македонија - Општина Кичево
R. e Maqedonisë - Komuna e KËRÇOVËS

Бр.-Нр. 09-2692/1

05 11 2009 год.-VII

КИЧЕВО-KERÇOVË

PROCEDURA INTERNE
PËR MËNYRËN E SHFRYTËZIMIT DHE MIRËMBAJTJEN E AUTOMJETEVE
TË REJA TË FURNIZUARA PËR UDHËTARË PËR QËLLIME ZYRTARE TË
KOMUNËS SË KËRÇOVËS

	Emër dhe mbiemër	Vendi i punës	Data	Nënshkrimi
Përgatiti				
Kontrolloi				
Lejoi				

1. LËNDA

- 1.1 Me këtë procedurë përshkruhet procesi i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve motorike të udhëtarëve në Komunën e Kërçovës për qëllime zyrtare.

2. QËLLIMI

- 2.1 Qëllimi i procedurës është shfrytëzimi efikas dhe efektiv dhe mirëmbajtja e automjeteve motorike të reja të furnizuara të Komunës së Kërçovës, 3 Opel korsa të reja (teksti i më tutjeshëm "Automjete motorike")

3. DOKUMENTE REFERUESE

3.1 Akte ligjore

- 3.1.1 Ligji për kontroll të brendshëm financiar publik;
- 3.1.2 Ligji për siguri të trafikut në rrugët;
- 3.1.3 Ligji për transport në trafikun rrugor.

3.2 Akte interne

- 3.2.1 Statut;
- 3.2.2 Rregullore për mënyrën e organizimit dhe Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, etj.

4. KUSHTE DHE MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË AUTOMJETEVE MOTORIKE TË UDHËTARËVE

- 4.1 Kjo procedurë zbatohet në kuadër të Komunës së Kërçovës dhe është obligative për të gjithë të punësuarit që shfrytëzojnë automjete motorike të udhëtarëve për qëllime zyrtare.
- 4.2 Automjete motorike të udhëtarëve (automjete zyrtare), në rastin konkret, automjete të reja motorike të furnizuara janë automjete që janë në pronësi të Komunës së Kërçovës dhe për menaxhimin e të cilave është e nevojshme posedimi i lejes për vozitje të kategorisë "B".
- 4.3 Automjeti motorik i udhëtarëve/automjeti zyrtar mund të shfrytëzohet pas lejimit paraprak nga udhëheqësi i subjektit Komuna e Kërçovës ose personi i nominuar nga ana e tij, me çka për të njëjtën duhet me patjetër të ekzistoj **Urdhëresë rruge** e përgatitur (**Shtojca nr.1**), me informata të shënuara të nevojshme dhe të dhëna për automjetin zyrtar, llojin e automjetit që do të shfrytëzohet dhe autorizimin adekuat.

5. PERSONA TË KYÇUR NË PROCES

- 5.1 Për zbatim të rregullit të kësaj procedure, secili në kuadër të kompetencave të veta janë përgjegjës:
- Udhëheqësi i subjektit ose personi të cilit i janë besuar kompetencat;
 - Udhëheqësi i sektorit / udhëheqësi i njësisë;
 - Vozitësi / i/e punësuar shfrytëzuesi i automjetit.

6. URDHËRESË RRUGE¹

6.1 Për çdo shfrytëzim të automjetit motorik të udhëtarëve/automjet zyrtar para fillimit të shfrytëzimit të automjetit, duhet me patjetër të ekzistoj urdhëresa rrugore e përgatitur dhe e lejuar. Urdhëresën e rrugës e përgatit vozitësi i automjetit dhe e njëjta është e nevojshme t'i përmbajë elementet vijuese:

- Titulli i subjektit juridik;
- Data e realizimit të udhëtimit zyrtar;
- Emri dhe mbiemri i vozitësit të automjetit motorik të udhëtarëve;
- Emri dhe mbiemri i shfrytëzuesit të automjetit;
- Marka/lloji dhe numri i regjistrimit të automjetit;
- Relacioni i udhëtimit;
- Obligimi/detyra zyrtare që do të realizohet;
- Koha e nisjes;
- Koha e kthimit;
- Numri i kilometrave para nisjes, numri i kilometrave pas përfundimit të udhëtimit zyrtar, kilometra të kaluara;
- Autorizim/nënshkrim i vozitësit / nënshrim i shfrytëzuesit të automjetit / nënshrim i personit të autorizuar.

7. MËNYRA E VEPRIMIT

7.1 Shfrytëzimi i automjetit zyrtar

7.1.1 Shfrytëzimi i automjeteve duhet të jetë i lejuar, arsyetuar, destinuar dhe racional dhe në pajtim me vizionin, misionin, qëllimet dhe fushëveprimin e Komunës së Kërçovës.

7.1.2 Automjetet zyrtare të Komunës së Kërçovës mund t'i shfrytëzojë vetëm i/e punësuar i/ja që ka leje për vozitje të kategorisë "B" të vlefshme dhe përvojë adekuate në vozitjen me të njëjtat.

7.1.3 Automjetet zyrtare shfrytëzohen vetëm për kryerjen e kompetencave të Komunës së Kërçovës. Çdo shfrytëzues i automjetit që disponon me urdhëresë të rregullt dhe të autorizuar të rrugës, para fillimit të shfrytëzimit të automjetit është e nevojshme të kryej:

- o Shqyrtim vizuel të automjetit dhe për dëmtimet eventuale të konstatuara, menjëherë ta njoftojë përgjegjësin e përcaktuar;
- o Shënimin e të dhënave të nevojshme në urdhëresën e rrugës, në pjesën e: ora e marrjes së automjetit, data, gjendja e kilometrave të kaluara në momentin e marrjes së automjetit;

7.1.4 Gjatë shfrytëzimit të automjetit motorik të udhëtarëve, shfrytëzuesi i automjetit ka të drejtë të shfrytëzojë derivate të naftës nga subjekti juridik, me të cilin është lidhur kontratë për furnizim publik të shërbimeve, duke siguruar dokumente të rregullta dhe të besueshme të kontabilitetit (llogari fiskale dhe vërtetim të llogarisë) dhe me të

¹ Urdhëresë rruge është dokument që përmban të dhëna për llojin e transportit, emrin dhe selinë e transportuesit, emrin dhe mbiemrin e vozitësit, të dhënat kryesore për drejtimin e vozitjes, numri i regjistrimit i automjetit, gjendja e numëruesit në fillim dhe në përfundim të vozitjes, të dhëna specifike për llojin e transportit dhe nënshrimi i personit të autorizuar që e ka dhënë urdhëresën (definicioni i urdhëresës së rrugës nga Ligji për transport në trafikun rrugor „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 68/04, 127/06, 114/09, 83/10, 140/10, 152/10, 17/11, 53/11, 6/12, 23/13, 120/13, 163/13, 187/13, 42/14, 112/14, 166/14, 20/15, 44/15, 97/15, 124/15, 129/15, 193/15, 37/16, 71/16, 64/18, 140/18, 163/18).

Komuna e Kërçovës

njëtat edhe një ekzemplar nga urdhëresa e rrugës, do të rimbursohet te sektori adekuat për çështje financiare. Vërtetimi i llogarisë i bashkangjitur dhe llogaria fiskale duhet të jenë të autorizuar nga udhëheqësi i shfrytëzuesit të automjetit zyrtar ose personi i autorizuar nga udhëheqësi i Komunës së Kërçovës.

7.1.5 Pas përfundimit të nevojës nga shfrytëzimi i automjetit zyrtar, shfrytëzuesi e përmbyll urdhëresën me plotësimin e të dhënave për orën e kthimit, gjendjen e kilometrazhit dhe numrin e kilometrave të kaluara. Gjatë kthimit të automjetit, i paraqit defektet eventuale mekanike dhe të tjera, në qoftë se, janë shkaktuar gjatë shfrytëzimit të tij nga personi të cilit i janë besuar kompetencat për mirëmbajtjen e automjeteve motorike të udhëtarëve në Komunën e Kërçovës.

7.1.6 Për shfrytëzimin e automjeteve motorike të udhëtarëve në Komunën e Kërçovës jashtë shtetit, personi që do ta vozisë duhet t'i sigurojë dokumentet e nevojshme nga institucionet kompetente (karton të gjelbërt, leje ndërkombëtare për vozitje, autorizim për shfrytëzimin e automjetit, etj.), të disponoj me Aktvendim për udhëtim zyrtar jashtë shtetit dhe urdhëresë ruge të rregulluar.

7.2 Ruajta e automjeteve

7.2.1 Pas përfundimit të udhëtimit zyrtar, shfrytëzuesi i automjetit është i obliguar ta parkoj automjetin në hapësirën për parkim, të destinuar për automjete të Komunës së Kërçovës.

7.3 Ndjekja e rregullsisë teknike të automjeteve

7.3.1 Për ndjekje të rregullsisë teknike të automjeteve motorike të udhëtarëve është person i obliguar (theksoni titull adekuat të vendit të punës), që është i shpërndarë në vendin e punës të theksuar dhe ka obligim që në vazhdimësi të kryej kontroll vizuel të automjeteve, për çka shfrytëzon **Listë për kontroll të automjeteve (Shtojca nr. 2)**.

7.3.2 Personi i obliguar për përkujdesje të automjeteve motorike të udhëtarëve ka obligim t'i kontrolloj automjetet para shfrytëzimit të tyre për shkuarje në rrugë zyrtare, pas njoftimit të marrë paraprak nga shfrytëzuesit e automjeteve zyrtare për periudhën për të cilën automjeti zyrtar do të shfrytëzohet dhe në qoftë se, konstaton gjendje të caktuara që shpiejnë se automjeti nuk mund të shfrytëzohet, për të njëjtën e njofton shfrytëzuesin e automjetit motorik të udhëtarëve dhe udhëheqësin e tij të përcaktuar.

7.4 Mirëmbajta, servisimi dhe paraqitja e defektit të automjeteve motorike të udhëtarëve

7.4.1 Personi i obliguar për përkujdesje të automjeteve motorike të udhëtarëve përkujdeset për mirëmbajtjen në vazhdimësi të higjienës së brendshme dhe të jashtme të automjetit. Sipas nevojës ndërmerr aktivitete për mirëmbajtjen e higjienës, me çka të njëjtat i dërgon në servis të autorizuar për larjen e automjeteve dhe për shërbimin e kryer, parashtrojnë dokumente të rregullta dhe të besueshme të kontabilitetit.

7.4.2 Automjetet motorike të udhëtarëve të Komunës së Kërçovës kanë servis të rregullt dhe të jashtëzakonshëm në varësi nga nevoja. Për serviset e rregullta, personi i obliguar për përkujdesje të automjeteve udhëheq evidencë në ekzemplar **Karton për servise të rregullta (Shtojca nr. 3)**.

7.4.3 Në qoftë se, konstatohet problem i caktuar i automjetit, personi i obliguar për përkujdesje për automjetet motorike të udhëtarëve, e dërgon automjetin në servis të autorizuar / furnizues, me të cilin Komuna e Kërçovës ka të lidhur kontratë për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve, në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizime publike.

Komuna e Kërçovës

- 7.4.4 Për serviset e kryera të automjeteve motorike të udhëtarëve të Komunës së Kërçovës, personi i obliguar për përkujdesje për automjetet, udhëheq evidencë në **Kartonin e servisit (Shtojca nr. 4).**
- 7.4.5 Automjetet motorike të udhëtarëve që janë të reja të furnizuara dhe të njëjtat ende janë nën afatin e garancës, servisi i tyre kryhet nga ana e personit juridik, nga ku janë të furnizuara automjetet ose servis i autorizuar nga ai.
- 7.4.6 Personi i obliguar për udhëheqjen e përkujdesjes për automjetet motorike të udhëtarëve në Komunën e Kërçovës është i obliguar që më së voni 15 ditë para dhe 15 ditë pas skadimit të periudhës për bartjen e pajisjes dimërore, të organizojë ndryshimin e pajisjes së automjeteve nga regjimi i verës në të dimërit dhe anasjelltas.
- 7.4.7 Çdo shfrytëzues i automjetit zyrtar që do të vërej në automjetin zyrtar defekt, të njëjtin e paraqit te personi i autorizuar për përkujdesje të automjeteve motorike të udhëtarëve, që ka për obligim të kryej diagnostifikimin e defektit dhe në varësi prej nevojave të ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për servisim të automjetit dhe informim të udhëheqësit adekuat / udhëheqësit të subjektit. Për udhëzimin e automjetit është e nevojshme të përgatitet urdhëresë në 2 kopje, që duhet të lejohet nga personat e autorizuar të Komunës së Kërçovës.
- 7.4.8 Në qoftë se, defekti i automjetit zyrtar ndodh jashtë territorit të selisë së Komunës së Kërçovës, shfrytëzuesi i automjetit ka për obligim ta njoftoj personin e obliguar për përkujdesje të automjeteve të udhëtarëve, që ka për obligim të japë udhëzime për mënyrën e veprimit.
- 7.4.9 Çdo riparim i kryer i automjeteve motorike të udhëtarëve në pronësi të Komunës së Kërçovës, personi i obliguar për përkujdesje të automjeteve ka për obligim ta shënoj në **Kartonin amzë të automjetit (Shtojca nr. 5).**

7.5 Dëmtimi ose vjedhja e automjeteve motorike të udhëtarëve / automjet zyrtar

- 7.5.1 Në qoftë se, në automjetin motorik të udhëtarëve, pronë e Komunës së Kërçovës, gjatë shfrytëzimit të tij, shkaktohet dëmtim (dëmtim i sipërfaqes së jashtme dhe brendësisë së automjetit motorik të udhëtarëve përmes rrugës mekanike), shfrytëzuesi i automjetit ka për obligim ta njoftoj personin e obliguar për përkujdesje për automjetet dhe në varësi të udhëzimeve të marra ka për obligim të qaset drejt përgatitjes së "Procesverbalit europian" (në rast kur dëmtimi është shkaktuar nga automjet tjetër), ose të thirrë asistencë nga organi kompetent për përgatitjen e procesverbalit.
- 7.5.2 Në qoftë se, gjatë shfrytëzimit të automjetit motorik të udhëtarëve për qëllime zyrtare, shkaktohet vjedhje e të njëjtit, shfrytëzuesi i automjetit ka për obligim ta njoftoj personin e obliguar për përkujdesje të automjeteve dhe në të njëjtën kohë në stacionin më të afërt policor ta paraqesë vjedhjen e shkaktuar.

7.6 Evidenca e automjeteve

- 7.6.1 Personi i obliguar për përkujdesje për automjetet motorike të udhëtarëve, pronë e Komunës së Kërçovës, ka për obligim të vendosë dhe të udhëheqë evidencë të posaçme – Karton amzë të automjetit (**Shtojca nr. 5**) dhe atë për:
- Llojin e automjetit;
 - Vitin e prodhimit;
 - Numrin e shasisë dhe fuqinë e motorit/vëllimi;
 - Të dhëna për regjistrim;
 - Të dhëna për servisim të automjetit zyrtar.

8. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE


8.1.1 Kjo procedurë hyn në fuqi me ditën e sjelljes, ndërsa do të zbatohet nga dt. **05.11.2019.**

9. DOKUMENTE

- 9.1 Shtojca 1: Urdhëresë për shfrytëzimin e automjeteve motorike të udhëtarëve / automjete zyrtare;
- 9.2 Shtojca 2: Listë për kontroll të automjeteve motorike të udhëtarëve / automjete zyrtare;
- 9.3 Shtojca 3: Karton për servis të rregullt të automjeteve motorike të udhëtarëve / automjete zyrtare;
- 9.4 Shtojca 4: Karton servisi për mirëmbajtje rrjedhëse të automjeteve motorike të udhëtarëve / automjete zyrtare;
- 9.5 Shtojca r 5: Karton amzë të automjeteve motorike të udhëtarëve / automjete zyrtare.

KOMUNA E KËRÇOVËS

Kryetar



.....
Fatmir Dehari